



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 199, Datë 21.07.2026

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “BUSHTRICA 2017” SH.P.K. PËR LICENCIM NË  
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 14, pika 3, të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 15 të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.07.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 671/3 prot., datë 16.07.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “BUSHTRICA 2017” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “BUSHTRICA 2017” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2726 prot., datë 27.10.2025, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Bushtica 2”, me kapacitet të instaluar 4,800 kW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Bushtricë, në Qarkun e Elbasanit.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 283, datë 06.11.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 08.11.2025 dhe 10.11.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 09.12.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- ERE po ashtu ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për fillimin e kësaj procedure, nëpërmjet shkresës nr. 2726/4 prot., datë 20.11.2025. Nga ana e MIE-s nuk ka pasur ndonjë qëndrim në lidhje me fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë.
- Me shkresën nr. 2726/3 prot., datë 13.11.2025, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e fillimit të procedurës dhe i ka kërkuar depozitimin e informacionit/dokumentacionit të aplikimit të konstatuar të paplotësuar ose të plotësuar pjesërisht.
- Pas korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë në lidhje me plotësimin e informacionit/dokumentacionit të munguar, ka rezultuar se nuk është depozituar dokumentacioni në lidhje me mbështetjen financiare, ndaj në mbështetje të kërkesës së shoqërisë për pezullimin e aplikimit, bordi i ERE-s me vendimin nr. 341, datë 23.12.2025, vendosi të pezullojë afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “BUSHTRICA 2017” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Bushtica 2”, me kapacitet të instaluar 4,800 kW, me vendndodhje në pellgun

ujëmbledhës të lumit Bushtricë, në Qarkun e Elbasanit, deri në depozitimin e dokumentacionit të munguar.

- Ky vendim i është njoftuar shoqërisë nëpërmjet shkresës së ERE me nr. 2726/9 prot., datë 29.12.2025.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 671/2 prot., datë 29.06.2026, shoqëria ka depozituar dokumentacion në lidhje me mbështetjen financiare, duke kërkuar rinisjen e procedurës së licencimit.
- Për sa depozituar nga shoqëria rezulton se plotësohet kushti për heqjen e pezullimit, por vlerësohet i nevojshëm një afat prej 30 ditësh për të vijuar korrespondencën me shoqërinë përpara se të merret vendimi përfundimtar në lidhje me kërkesën e saj për licencim.

#### **Heqja e pezullimit dhe zgjatja e vendimmarrjes**

- Në nenin 14, pika 3, të Rregullores parashikohet se: *Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.*
- Për gjithë sa më sipër, në zbatim të nenit 14, pika 3 e Rregullores, vlerësohet që të hiqet pezullimi dhe të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së bordit në lidhje me kërkesën e shoqërisë “BUSHTRICA 2017” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Bushtrica 2”, me kapacitet të instaluar 4,800 kW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Bushtricë, në Qarkun e Elbasanit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të heqë pezullimin e vendosur me vendimin e bordit nr. 341 datë 23.12.2025 “Mbi pezullimin e afatit të vendimmarrjes së bordit të ERE-s lidhur me shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Bushtrica 2017” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”.
2. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë “BUSHTRICA 2017” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Bushtrica 2”, me kapacitet të instaluar 4,800 kW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Bushtricë, në Qarkun e Elbasanit.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “BUSHTRICA 2017” sh.p.k., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**

**NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM**

**ANËTAR I BORDIT**

**Petra LIKA**